


MARRËDHËNIET E PËSHËNDETSHME & SHFRYTËZIMI

SI ËSHTË NJË MARRËDHËNIE JO E SHËNDETSHME?

Kjo mund të ndodhë kur dikush:

-  Kontrollon veprimet, vendndodhjen, kontaktet dhe financat tuaja
-  Ju cenon fizikisht
-  Kërcënon për t'ju cenuar ju ose të dashurit tuaj
-  Shkatërron pronën në zemërimin e sipër
-  Ju abuzon emocionalisht duke ju sharë dhe nënçmuar
-  Ju izolon nga të tjerët, duke shkëputur marrëdhëniet
-  Ju bën presion që të përdorni substanca narkotike
-  Ju bën presion që të përfshiheni në aktivitete seksuale me ta ose me të tjerët
-  Ju bën presion për t'u shkaktuar lëndime të tjerëve ose për të kryer krime – që njihet ndryshe si shfrytëzim kriminal
-  Ju bën presion për të përfshirë të tjerët në aktivitete të dëmshme



SHFRYTËZIMI SEKSUAL

Shfrytëzimi seksual ndodh kur një person detyrohet, manipulohet ose mashtrohet për të kryer aktivitete seksuale me të tjerët.

Kjo mund të ndodhë personalisht ose në internet dhe fatkeqësisht mund t'i ndodhë kujtdo. Shpesh, njerëzit që shfrytëzojnë seksualisht të tjerët mund të përdorin dhunë dhe ta frikësojnë ose ta detyrojnë një person të ndihet sikur nuk ka zgjidhje tjetër.

Kur shfrytëzohesh ose shfrytëzon të tjerët kjo nuk është asnjëherë KONSENSUALE.

Ndonjëherë është e vështirë të kuptosh kur je në një marrëdhënie abuzive, veçanërisht nëse të manipulojnë për të menduar ndryshe. Kjo mund të jetë çfarëdolloj marrëdhënie, qoftë me një partner romantik, mik, pjesëtar të familjes ose profesionist të ndonjë shërbimi.

A MESSAGE FOR STAFF

Are you confident the young person can understand this text?

If not, please scan the QR code so they can access an alternative version of this leaflet.



saferlondon

Safer London është një shoqatë bamirëse e regjistruar në Angli dhe Uells me nr. 1109444; dhe një shoqëri e kufizuar me garanci nr. 5190766. www.saferlondon.org.uk